

**URDHËR**  
**Nr. 127, datë 4.4.2022**

**PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË  
AGJENCISË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit, nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 102, datë 4.2.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ngarkimin e znj. Ledina Beqiraj Agalliu për ushtrimin e detyrave të drejtorit të përgjithshëm, të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), krahas ushtrimit të detyrës aktuale të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.
  2. Znj. Ledina Beqiraj Agalliu do të ushtrojë detyrat shtesë të drejtorit të përgjithshëm të AKZM-së, duke filluar nga data 4.4.2022 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.
  3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe të gjitha drejtoritë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**Mirela Kumbaro Furxhi**